



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-075

Prishtinë, më 14 dhe 15 nëntor 2016, në orën 9:50
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 DHE 15
NËNTOR 2016**

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit se në mungesë të kuorumit nuk mund të vazhdohet me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës. Ai tha se mbledhja e Kryesisë së Kuvendit do ta mbahet nesër, më 15 nëntor 2016, në orën 12:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, më 15 nëntor 2016, në orën 12:00

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

* * *

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për vazhdimin e seancës plenare, e filluar më 28 tetor 2016.

* * *

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 24 dhe 26 tetor 2016

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 26 tetor 2016.

* * *

2. Përgatitjet për vazhdimin e seancën plenare, e filluar më 28 tetor 2016

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e filluar më 28 tetor 2016, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit t'i vazhdojë punimet të enjten, më 17 nëntor 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

11. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës (Rundi II - votim i fshehtë),

14. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Medie (votim i fshehtë),

15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie,

16. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga tetë deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës,

17. Debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga nëntë deputet tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundëshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Në vazhdim, kryetari i GP të LVV, Glauk Konjufca diskutoi lidhur me kërkesën e 40 deputetëve të Kuvendit për mbajtjen e Seancës së jashtëzakonshme, si dhe ngriti shqetësimet e tij për tërheqjen e nënshkrimit të një deputeti nga radha e GP të PDK-së nga lista e grupit të deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme. Diskutimi i z. Konjufca është dhënë në transkript.

Pas këtij diskutimi, nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti dhe kryetari i GP të LVV, Glauk Konjufca e lëshuan mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i njoftojë të pranishmit se në mungesë të kuorumit nuk mund të vazhdohet me shqyrtimin e pikave tjera të rendit të ditës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale